

Në bazë të dispozitave të nenit 21. të Ligjit nr.03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.31/2008) dhe ndryshim plotësimeve përkatëse të Ligjit bazik me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, Komisioni i Auditimit të KRU "Hidromorava"-SH.A, Komisioni i Auditimit në mbledhjen e rregullt me datë 31.12.2024, ka marrë këtë:

V E N D I M

I. Rishpallet për herë të katërt /4/ konkursi publik për pozitën e zyrtarit të lartë.

1. Zyrtar për Auditim të Brendshëm i Kompanisë Rajonale të Ujësjetësimit "Hidromorava"-SH.A.

II. Konkursi publik të ri-shpallet sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neni 21, paragrafi 21.4 dhe neni 17.1. që plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pika (d), (f), (j), (k), dhe (l), si dhe kriteret e përgjithshme.

A r s y e t i m

Komisioni i Auditimit i Kompanisë Rajonale të Ujësjetësimit "Hidromorava" -SH.A. në Gjilan, me datë 31.12.2024 ka marrë Vendim për ri-shpallje të konkursit publik për pozitën Zyrtar për Auditim të Brendshëm.

Konkursi Publik është shpallur (për herë të tretë) me datë 07.10.2024 sipas kërkesave për këtë pozitë dhe kërkesave të përgjithshme ligjore.

Pas shqyrtimit të aplikacioneve Komisioni i Auditimit ka konstatuar se nuk është plotësuar numri i nevojshëm i kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret e përgjithshme sipas konkursit publik.

Andaj, Komisioni i Auditimit duke e parë të nevojshme plotësimin e kësaj pozite me status të rregullt vendosi të ri-shpall konkursin publik për herë të katërt (4) për pozitën: Zyrtar për Auditim të Brendshëm në KRU "Hidromorava"-SH.A.

Nga të cekurat si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Obligohet Sekretarja e Ndërmarrjes që të ndërmerrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, të publikoj konkursin publik për pozitën si në dispozitiv të këtij vendimi dhe të bëjë shpalljen sipas ligjeve në fuqi dhe bazës ligjore.

Kryesuesja e Komisionit të Auditimit

(znj. Ferdane Tahiri Sylejmani)

